



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Shoqeria “A&T” sha

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla “Sky Tower” Kati 7, Ap. Nr. 3, Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë.

Procedura e prokurimit: : ”Kërkesë për Propozim” **“Blerje karburanti, naftë për automjetet dhe kaldajat për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme për vitin 2018”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **Ref: 87653-09-27-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është **Blerje karburanti, naftë për automjetet dhe kaldajat për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme për vitin 2018, Tiranë**

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike *Nr.39, date 01.10.2018*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Bashkimi i operatorëve ekonomik “Eroil” sha & “Das Oil” shpk
NUIS- L32230076S & NUIS- L52230020G**

Çmimi total i ofertës i shprehur në marzh fitimi në përqindje = 9.3 %.

- 2- Operatori ekonomik “A&T” sha NUIS- L32320008H**

Çmimi total i ofertës i shprehur në marzh fitimi në përqindje = 13.8 %.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- 1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Eroil” sha & “Das Oil” shpk
NUIS- L32230076S & NUIS- L52230020G**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi nga bashkimi i

operatorëve ekonomik “Eroil” sha dhe “Das Oil” shpk rezulton se operatori ekonomik “Das Oil” shpk ka paraqitur dokumentin “Vërtetim Debie” me Nr.18519/1, date 05.10.2018 në të cilin deklarohet shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike por nuk përcaktohen kontratat e energjisë për të cilat operatori ekonomik ka shlyer keto detyrime.

Në vërtetim përcaktohet “...për kontratat bashkëlidhur...” por nuk ka dokumentacion bashkëlidhur këtij vërtetimi i cili të përcaktojë kontratat me kodet përkatëse për të cilat ky detyrim është shlyer duke mos plotësuar Kriteret e Vecanta per Kualifikim,pika 1, germa (b) të dokumentave të tenderit.

Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik, Kreu III, Seksioni II, Neni 27, pika 5, gërma (c) ligjvënësi përcakton:

“... një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike **të kontratave të energjisë** që ka operatori ekonomik që është i rregjistruar në Shqipëri...”

Sa më sipër në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqiste bashkëlidhur vërtetimit të debisë dhe kontratat e energjisë për të cilat ky operator ekonomik ka shlyer detyrimet.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Ne kriteret e vecanta per kualifikim pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2.1 përcaktohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2015, 2016,2017) të paraqitura prane autoriteteve përkatëse dhe te konfirmuara nga ky Autoritet (Administrata tatimore) si dhe te shoqeruara me akt-ekspertizen e ekspertit kontabel te autorizuar.

Në plotësim të kësaj pike operatori ekonomik “Das Oil” shpk bilancin për vitin 2017 nuk e ka të konfirmuar nga Administrata Tatimore duke mos plotësuar kriterin sa më sipër cituar përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Në Kreun VIII, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3, paragrafi i parë i VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, parashikohet: “Secili prej anetareve te këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato

teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“A&T”sha** me adresë kryesore: Adresa : Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla “Sky Tower” Kati 7, Ap. Nr. 3, Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë, se oferta e paraqitur me marzh fitimi të shprehur në përqindje prej 13.8% është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.10.2018

Ankesa: Gjate afatit Ligjor per pritjen e ankesave të shoqërive pjesmarrëse në tender në mbeshtetje Nenit 63 te Ligjit 9643 date 20.11.2006 “ Per prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X,Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për **“Blerje karburanti, naftë për automjetet dhe kaldajat për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme për vitin 2018”** nuk eshte paraqitur asnje ankesa

